ENSO HYDRO ENERGJI SHPK

Pasqyrat Financiare individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(me raportin e Audituesit të pavarur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të pavarur	i-iii
Pasqyra individuale e pozicionit financiar	1-2
Pasqyra individuale e performancës financiare	3
Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra individuale e flukseve monetare	5
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	6
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale	7-18

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Enso Hydro Energji Sh.p.k

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë Enso Hydro Energji Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën individuale të performancës, pasqyrën individuale të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me me kërkesat e raportimit financiar në Shqipëri siç përshkruhet në politikat kontabël të paraqitura në Shënimin 3, të cilat bazohen në kërkesat e raportimit në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), përveç mungesës së konsolidimit të investimeve në filiale.

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të Tjera

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 u audituan nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion pa rezervë mbi ato pasqyra financiare më 12 nëntor 2019.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë proçesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, hartojmë dhe zbatojmë proçedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i mashtrimit, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojme që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare individuale ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.
- marrim evidence të mjaftueshme të auditimit në lidhje me informacionin financiar ose aktiviteteve të biznesit brenda Shoqërisë për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare individuale. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e auditimit të Shoqërisë. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë proçesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirana, Shqipëri
17 prill 2020

Kledian Kodra, Ecf

Grant Thornton Sh.p.k. NIPT K 61923007 M Tirana ALBANIA

Enso Hydro Energji Shpk
Pasqyra individuale e Pozicionit Financiar
(shumat në Lekë)

Nr	Aktivet	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Aktivet afatshkurtra			
	► **Aktivet monetare**	4	**22,465,977**	**26,750,176**
	1 Banka		22,357,291	26,687,970
	2 Arka		108,686	62,206
	► **Investime**		-	-
	1 Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit		-	-
	2 Aksionet e veta		-	-
	3 Të tjera investime financiare		-	-
	► **Të drejta të arkëtueshme**	5	**4,941,435**	**8,969,383**
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit		1,271,746	-
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit		-	5,299,694
	3 Nga njësitë ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
	4 Të tjera		3,669,689	3,669,689
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar		-	-
	► **Inventarët**		-	-
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
	2 Prodhime në proces dhe produkte gjysëm të gatshme		-	-
	3 Produkte të gatshme		-	-
	4 Mallra		-	-
	5 Aktive biologjike		-	-
	6 AAGJM të mbajtura për shitje		-	-
	7 Parapagime për inventar		-	-
	► **Shpenzime të shtyra**		-	-
	► **Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara**	7	**341,904,911**	**305,043,859**
I	***Totali aktiveve afashkurtra***		**369,312,323**	**340,763,418**
	Aktivet afatgjata			
	► **Aktivet financiare**		**2,190,642,846**	**2,198,082,103**
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	6	821,870,060	821,870,060
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit	7	1,368,772,786	1,376,212,043
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrjeje		-	-
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		-	-
	6 Tituj të tjerë të huadhënies		-	-
	► **Aktivet materiale**	8	**117,435**	**156,579**
	1 Toka dhe ndërtesa		-	-
	2 Impiante dhe makineri		-	-
	3 Të tjera instalime dhe pajisje		117,435	156,579
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces		-	-
	► **Ativet biologjike**		-	-
	► **Aktive jo materiale**		-	-
	1 Koncesione,patenta,liçenca,marka tregtare,të drejta dhe aktive të ngjashme		-	-
	2 Emri i Mirë		-	-
	3 Parapagime për AAJM		-	-
	► **Aktive tatimore të shtyra**		-	-
	► **Kapital i nënshkruar i papaguar**		-	-
II	***Totali aktiveve afatgjata***		**2,190,760,281**	**2,198,238,682**
	Aktive totale		**2,560,072,604**	**2,539,002,100**

Enso Hydro Energji Shpk
Pasqyra individuale e Pozicionit Financiar (vazhdim)
(shumat në Lekë)

Nr	Detyrimet dhe kapitali	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	▶Detyrime afatshkurtra:		**6,047,376**	**6,058,583**
	1 *Titujt e huamarrjes*		-	-
	2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*		-	-
	3 *Parapagime nga klientët*		-	-
	4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*	9	4,335,499	4,526,622
	5 *Dëftesa të pagueshme*		-	-
	6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit*	**9**	330,971	177,725
	7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		-	-
	8 *Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore*	10	14,508	13,392
	9 *Të pagueshme për detyrimet tatimore*	10	1,366,398	1,340,844
	10 *Të tjera të pagueshme*		-	-
	▶Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		**43,339,184**	**21,545,703**
	▶Të ardhura të shtyra		-	-
	▶Provizione		-	-
I	**TotaliiDetyrimeve afatshkurtra**		**49,386,560**	**27,604,286**
	▶Detyrime afatgjata			
	1 *Titujt e huamarrjes*	11	599,141,666	604,791,717
	2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*		-	-
	3 *Arkëtimet në avancë për porosi*		-	-
	4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*		-	-
	5 *Dëftesa të pagueshme*		-	-
	6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit*		-	-
	7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		-	-
	8 *Të tjera të pagueshme*		-	-
	▶Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
	▶Të ardhura të shtyra		-	-
	▶ Provizione		-	-
	1 *Provizione për pensionet*		-	-
	2 *Provizione të tjera*		-	-
	▶Detyrime tatimore të shtyra		-	-
II	**Totali i Detyrimeve afatgjata**		**599,141,666**	**604,791,717**
	Detyrime totale		**648,528,226**	**632,396,003**
	▶Kapitali dhe Rezervat		-	-
	▶Kapitali i Nënshkruar	12	**2,612,737,000**	**2,612,737,000**
	▶Primi i lidhur me kapitalin		-	-
	▶Rezerva rivlerësimi		-	-
	▶Rezerva të tjera		-	-
	1 *Rezerva ligjore*		-	-
	2 *Rezerva statutore*		-	-
	3 *Rezerva të tjera*		-	-
	▶Fitimi i pashpërndarë		**(706,130,903)**	**19,505,117**
	▶Fitim/(humbja) e vitit		**4,938,281**	**(725,636,020)**
	TotaliiKapitalit		**1,911,544,378**	**1,906,606,097**
III	**Totali i detyrimeve dhe kapitalit**		**2,560,072,604**	**2,539,002,100**

Shënimet e paraqitura në faqen 7 deri në faqen 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare individuale janë miratuar nga Bordi Drejtues i Enso Hydro Energji Shpk më 17 prill 2020, dhe janënënshkruar nga:

Ulrike Krapinger dhe Daniela Till
Administrator i Përgjithshëm

enso hydro energji
NUIS: L17017010Q
TIRANË ALBANIA

Rezarta Kocollari
Kontabiliste

	Shënime	2019	2018
► **Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**	**13**	**12,754,745**	**14,221,341**
► **Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces**		**-**	**-**
► **Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar**		**-**	**-**
► **Të ardhura të tjera të shfrytëzimit**		**-**	**-**
► **Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**		**-**	**-**
1*Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme*		-	-
2 *Të tjera shpenzime*		-	-
► **Shpenzime të personelit**	**14**	**(174,096)**	**(160,704)**
1 Paga dhe shpërblime		(69,888)	(64,512)
2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(104,208)	(96,192)
► **Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale**		**-**	**-**
► **Shpenzime konsumi dhe amortizimi**	8	**(39,144)**	**(52,192)**
► **Shpenzime të tjera shfrytëzimi**	15	**(10,844,078)**	**(21,146,663)**
► **Të ardhura të tjera**	**16**	**40,939,178**	**43,879,063**
1 Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)	16	40,939,178	43,879,063
2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)		**-**	**-**
3 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)		-	-
► **Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra**		**-**	**(647,906,689)**
► **Shpenzime financiare**		**(37,698,324)**	**(114,470,176)**
1*Shpenzime interesinga njësitë brenda grupit*	16	(23,243,711)	(22,745,840)
2 *Shpenzime të tjera financiare*	17	(14,454,613)	(91,724,336)
► **Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet**		**-**	**-**
► **Humbja para tatimit**		**4,938,281**	**(725,636,020)**
► **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**	18	**-**	**-**
1 *Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin*		-	-
2 *Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë*		**-**	**-**
3 *Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve*		**-**	**-**
► **Humbja e vitit**		**4,938,281**	**(725,636,020)**
► **Fitimi/Humbja për:**			
1 *Pronarët e njësisë ekonomike*		**-**	**-**
2 *Interesat jo-kontrolluese*		**-**	**-**

Shënimet në faqet 7 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

	2019	2018
► **Humbja e vitit**	**4,938,281**	**(725,636,020)**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-
Diferencat (+/-) nga konvertimi i monedhës në veprimtari të huaja	-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje	-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	-	-
► **Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin**	-	-
► **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin**	**4,938,281**	**(725,636,020)**
► **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për:**		
Pronarët e njësisë ekonomike	-	-
Interesat jo-kontrolluese	-	-

Shënimet në faqen 7 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

	Shënime	2019	2018
► **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit**			
Humbja para tatimit		**4,938,281**	**(725,636,020)**
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzimet financiare jomonetare			
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	39,144	52,192
Zhvlerësimi i investimeve		-	647,906,689
Të ardhurat nga interesi	16	(40,939,179)	(43,879,063)
Shpenzime interesi	16	23,243,711	22,745,840
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:			
Shumat nga shitja e aktiveve materiale		-	-
Ndryshimet në kapitalin punues:			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(32,833,104)	917,104
Rënie/(rritje) në inventarë		-	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		21,782,274	(508,753)
Parapagim tatim fitimi		-	(768,168)
Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		**(23,768,873)**	**(99,170,179)**
► **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit**			
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		**-**	**-**
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		**-**	**-**
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		**-**	**-**
Pagesa për blerjen e investimeve		**-**	**-**
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		**-**	**-**
Dividentë të arkëtuar		**-**	**-**
Hua të disbursuara		**-**	**-**
Arkëtime nga huatë		**-**	170,151,007
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		**-**	**170,151,007**
► **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit**			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		**-**	**-**
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		**-**	**-**
Hua të arkëtuara		35,289,128	-
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		**-**	**-**
Riblerje e aksioneve të veta		**-**	**-**
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		**-**	**-**
Pagesa e huave		(15,804,454)	(47,899,740)
Pagesa për detyrimet e qirasë finanicare		**-**	**-**
Interes i paguar		**-**	**-**
Dividendë të paguar		**-**	**-**
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		**19,484,674**	**(47,899,740)**
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë		**(4,284,199)**	**23,081,088**
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	**4**	**26,750,176**	**3,669,088**
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	**4**	**22,465,977**	**26,750,176**

Shënimet në faqen 7 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Enso Hydro Energji Shpk
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor
(Shumat në Lekë)

		Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
►	**Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018**	**2,612,737,000**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**22,652,817**	**(3,147,700)**	**2,632,242,117**		**2,632,242,117**
	Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-		(725,636,020)	**(725,636,020)**		**(725,636,020)**
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-	-					
	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-	-					
	Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike:	-	-	-	-	-	-					
	Transferimi i humbjes/ fitimit	-	-	-	-	-	-	(3,147,700)	3,147,700	-		-
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	-	-	-					
►	**Pozicioni financiar më 1 janar 2019**	**2,612,737,000**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**19,505,117**	**(725,636,020)**	**1,906,606,097**		**1,906,606,097**
	Fitimii vitit	-	-	-	-	-	-		4,938,281	**4,938,281**		**4,938,281**
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-					
	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
	Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike:	-	-	-	-	-	-					
	Transferimi i humbjes	-	-	-	-	-	-	(725,636,020)	725,636,020	-		-
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	-	-	-					
►	**Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019**	**2,612,737,000**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**(706,130,903)**	**4,938,281**	**1,911,544,378**		**1,911,544,378**

Shënimet në faqet 7 deri në 18 janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

1. Njësia raportuese

Enso Hydro Energji Sh.p.k ("Shoqëria") është një filial i zotëruar në masën 80% nga enso hydro GmbH, e cila është edhe shoqëria kontrolluese perfundimtare e grupit. Pjesa e mbetur prej 20% e kuotave të kapitalit zotërohet nga International Finance Corporation (IFC).

Shoqëria u themelua më 3 gusht 2011 dhe u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 17 gusht 2011 me numër identifikimi L12017010Q dhe seli në Tiranë, Shqipëri. Administratorët e shoqërisë janë Znj. Ulrike Krapinger dhe Znj. Daniela Till.

Selia e shoqërisë është në rrugën Jul Variboba, Vila nr. 10, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar si një entitet i tatueshëm në Zyrën Tatimore të Qarkut të Tiranës me numër identifikimi L12017010Q. Numri i të punësuarve më 31 dhjetor 2019 është 2 (31 dhjetor 2018: 2).

Aktiviteti kryesor. Veprimtaria kryesore e shoqërisë është ndërtimi, përdorimi, blerja dhe shitja e hidrocentraleve, prodhimi i energjisë elektrike dhe shitja e saj me shumicë për konsumatorët dhe shpërndarësit.

Shoqëria realizon objektivat e saj duke themeluar një portofol të qëndrueshëm investimesh në hidrocentrale të vegjël e të mesëm. Shoqëria është krijuar për të përmbushur objektivat e enso hydro GmbH për investime të tilla në Shqipëri. Enso hydro GmbH investon në projekte centralesh elektrike, kryesisht nëpërmjet filialeve të huaja të krijuara për qëllime të posaçme në rajonet e synuara.

Filialet. Enso Hydro Energji Sh.p.k ka blerë tre shoqëri të quajtura, Hasi Energji Sh.p.k, Lengarica & Energy Sh.p.k dhe Mati Hydropower Shpk
Shoqëria zotëron 99.9% të kuotave të Lengarica & Energy Shpk, ndërsa kuotat e mbetura zotërohen nga Hasi Energji Shpk Lengarica është njëshoqëri e themeluar nga Hasi Energji Shpk për të përmbushur të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga një marrëveshje koncesioni me Ministrinë e Industrisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë (Autoriteti kontraktues) për ndërtimin e një hidrocentrali në Lengaricë-Petran, Përmet. Për të përfituar pronësinë dhe kontrollin e plotë të Lengarica & Energy Shpk, shoqëria ka blerë 100% të aksioneve të Hasi Energji Shpki cili është gjithashtu përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktues për këtë marrëveshje koncesionare deri në momentin që hidrocentrali do të filloje punën.
Shoqëria gjithashtu zotëron 90.01% të kuotave të Mati Hydropower Shpk, i cili zotëron një marrëveshje koncesioni për ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Mat, Mat, Shqipëri.

Hidrocentrali i Lengarica & Energy Shpk u ndertua ne Dhjetor 2015 me fuqi 8,960 kW, për prodhimin e energjisë elektrike prej 32,190,000 kWh, ndërsa Hidrocentrali i Mati Hydropower Shpkpritet të ketë një fuqi totale të instaluar prej 38,000 kW për prodhimin e 134,700,000 kWh energji.
Të dyja marrëveshjet koncesionare janë përpiluar sipas formës BOT (Ndërto, Shfrytëzo dhe Transfero tek Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të periudhës së koncesionit prej 35 vjetësh).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe legjislacionin shqiptar. Kuadri kontabël i aplikuar bazohet në politikat kontabël të paraqitura në Shënimin 3, të cilat bazohen në kërkesat e raportimit në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), përveç mungesës së konsolidimit të investimeve në filialet Lengarica & Energy Sh.p.k, Mati Hydropower Sh.p.k dhe Hasi Energji Sh.p.k. Më poshtë janë paraqitur politikat kryesore kontabël të aplikuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.
Shoqëria përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SKK. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare individuale duhet të lexojnë këto pasqyra si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 për të marrë informacion mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe ndryshimet në pozicionin financiar të grupit në tërësi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.2 Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur nga Drejtimi mbi bazën e parimit të vijimësisë. Në kryerjen e këtij vlerësimi, Drejtimi kreu një analizë të hollësishme duke marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat në dispozicion dhe pozicionin financiar të shoqërisë, qëllimet aktuale, përmirësimin e pritshëm në përfitueshmërinë e aktivitetit të shfrytëzimit dhe aksesin në burimet financiare të grupit, në mënyrë që të konkludojë nëse shoqëria mund të vazhdojë të funksionojë sipas parimit të vijimësisë në të ardhmen e parashikueshme. Nën "të ardhmen e parashikueshme", Drejtimi merr në konsideratë të gjitha informacionet e disponueshme për të ardhmen, e cila është të paktën, por nuk kufizohet në, dymbëdhjetë muaj nga përfundimi i periudhës së raportimit. Përfundimi nga analiza e mësipërme është se shoqëria nuk përballet me ndonjë problem operimi dhe nuk parashikon ndonjë deri në fund të vitit 2020. Për më tepër, Drejtimii enso hydro GmbH ka shprehur angazhimin për të vazhduar mbështetjen e aktivitetit të shoqërisë.

2.3 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare individuale paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin shoqëria kryen aktivitetin e saj.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare individuale kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material në periudhat e ardhshme është përfshirë në shënimin 6-zhvlerësimi i titujve të pronësisë në njësitë ekonomike brenda grupit.

3. Politikat e rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë njësi ekonomike të kontrolluara nga Shoqëria. Kontrolli ekziston kur Shoqëria ka fuqinë, direkt ose indirekt, të drejtojë politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit, merren parasysh të drejtat e mundshme të votimit që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme. Bazuar në kerkesat lokale ligjore dhe mbikqyrse, shoqërisë i kërkohet të raportojë si pasqyrat financiare të konsoliduara, ashtu edhe paketën e plotë të pasqyra financiare individuale të shoqërisë mëmë. Këto pasqyra financiare individuale nuk konsolidojnë aktivitetet e filialeve së saj, por pasqyrat financiare të konsoliduara që përputhen me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit janë në dispozicion për përdorim publik.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.Aktivet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të momentit kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten bazuar në koston historike në monedhë të huaj, përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga konvertimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje.

Monedha Euro (e cila është monedha kryesore me të cilën operon shoqëria) u konvertua me kursin 121.77 (2018: 123.42) Lekë.

3.3 Instrumentet financiarë

Instrumentet financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare, dhe llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera.

Instrumentet financiarë joderivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes,dhe çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur në thelb kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare përfshijnë arkën, llogaritërrjedhëse dhe depozitat afatshkurtër me bankat, të cilat fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozitat pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre.

Llogaritëe arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Një provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshmeregjistrohet kur ekzistojnë evidence objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në afatet fillestare të përcaktuara. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të riorganizohet financiarisht konsiderohen tregues që llogaria e arkëtueshme është zhvlerësuar. Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara, të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Instrumentet financiarë (vazhdim)

Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë minus kostot e transaksionit ndërsa më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse

Titujt e pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse njihen fillimisht me kosto, dhe më pas maten me kosto minus humbjet nga zhvlerësimi.

Të tjera

Instrumente të tjerë financiarë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, minus çdo zhvlerësim, supozohen të jenë të përafërta me vlerat e tyre kontabël.

3.4 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nqs përfshihet), çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të kryera gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtime në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të një zëri përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur të aktivit, dhe njihen neto në "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën rënëse për të gjitha aktivet afatgjata materiale, mbi jetën e dobishme të vlerësuar të secilës pjesë të një aktivi afatgjatë material duke nisur nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.Jetëgjatësia e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metodat përkatëse të amortizimit janë si më poshtë:

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma amortizimit
Instalime dhe pajisje të tjera	Vlera e mbetur	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.5 Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese mjetesh monetare (CGU)është më e madhja midisvlerës së saj në përdorim dhe vlerëssë drejtë të saj minus kostot e shitjes. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara monetare skontohen duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Për qëllime të testimit të zhvlerësimit, aktivet grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë hyrje të mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm, të cilat janë të pavarura nga hyrjet në mjete monetare të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve ("CGU")

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e "CGU" së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga zhvlerësimi në lidhje me "CGU" janëshpërndarëpër të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve në njësi (grup njësish) në baza proporcionale. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë indikacion se humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi anullohet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anullohet vetëm në atë masë që vlera kontabël neto e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar, duke zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, nëse nuk do tëishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

3.6 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe ka një mundësi që tëkërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi për fondet e investuara, huatë tek njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet, humbjet nga kursi i këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtëpërsëdrejti nëkapital ose të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose i arkëtueshëm mbi fitimin e tatueshëmose humbjen evitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës ose në datën e raportimit, dhe të gjitha ndryshimet e detyrimeve të tatimit për vitet e kaluara.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime fiskale.

Aktivet për tatime të shtyra njihen për humbje tatimore të papërdorur dhe diferencat e zbritshme të përkohshme në masën qëështë e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion për tu përdorur kundrejt tyre. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në anulimin e diferencave të përkohshme tatimore. Nëse diferencat e përkohshme tatimore nuk mjaftojnë për të njohur të plotë një aktiv tatimor të shtyrë, atëherëkonsiderohen fitimet e ardhshme të tatueshme, tërregulluarapër anulimet e diferencave të përkohshme ekzistuese, bazuar në planin e biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën në të cilën nuk është më e mundur të realizohet përfitim tatimor; këto zvogëlime anulohen kur rriten mundësitë për fitime të ardhshme të tatueshme.

Aktivet e panjohura tatimore të shtyra rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që është bërë e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave mund të përdorentë jenëtë mundshme.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose që hyjnë në zbatim nëmënyrë substanciale në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të pasojnë nga mënyra në të cilën shoqëriapret të rimarrë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompesohen vetëm nëse disa kritere të caktuara përmbushen.

Legjislacioni tatimor shqiptar, i miratuar ose në zbatim në mënyrë substanciale në datën e raportimit, është subjekt i interpretimeve të ndryshme në lidhje me aplikimin mbi transaksionet dhe aktivitetet e shoqërisë. Rrjedhimisht, trajtimettatimore të vendosuranga menaxhimi dhe dokumentacioni zyrtar mbështetës mund të kundërshtohen nga autoritetet tatimore. Periudhat fiskale mbeten të hapura për t'u audituarnga autoritetet tatimore për tre vite kalendarike para vitit kur është marrë vendimi për rishikim. Në rrethana të caktuara, auditimetmund të mbulojnë periudha më të gjata.

Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat, të përcaktuara nga menaxhimi, të cilat ka më shumë gjasa që të mos rezultojnë në vendosjen e taksave shtesë nëse vendimetdo të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në fuqi në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo çështje gjyqësoretë njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjobat, interesat dhe tatime të tjera mbi fitimin njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit për shpenzimete nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.10 Përfitimet e punonjësve

Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve

Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve njihen si shpenzim kur ofrohet shërbimi i lidhur me to. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet nëse shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kaluar të ofruar nga punonjësi dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

Pensionet e detyrueshme

Shoqëria, gjatë rrjedhës normale të biznesit, bën pagesa për llogari të vet dhe punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet e detyrueshme sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të Shoqërisë njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

4. Aktivet monetare

	31 dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Banka në Lekë	66,644	2,055,320
Banka në Euro	22,290,647	24,632,650
Arka	108,686	62,206
Totali	**22,465,977**	**26,750,176**

Mjetet monetare në bankë në Euro më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë në Raiffeisen Bank Albania, grupi i së cilës (Raiffeisen International AG) është klasifikuar A-2 nga S&P dhe në Intesa SanPaolo Bank Albania sha, grupi i së cilës (Intesa SanPaolo Bank) është klasifikuar A-2 ngaS&P.

5. Të drejta të arkëtueshme

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	-	5,299,694
Të arkëtueshme nga palë të treat	1,271,746	-
Tatim mbi fitimin i parapaguar	3,669,689	3,669,689
Totali	**4,941,435**	**8,969,383**

6. Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit

Filialet	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018	Pronesia ne %
Lengarica & Energy Shpk	493,524,127	493,524,127	99.9
Mati Hydropower Shpk	296,778,200	296,778,200	90.0
Hasi Energji Shpk	31,567,733	31,567,733	100.0
Totali	**821,870,060**	**821,870,060**	

Më 31 dhjetor 2018, është njohur një fond për zhvlerësim për filialet në vlerën e 676,906,689 Lekë (Lengarica & Energy Shpk 493,942,402 Lekë, Mati Hydropower Shpk 122,369,800 Lekë dhe Hasi Energji Shpk 31,594,487 Lekë). Testi i zhvlerësimit e konsideroi secilin filial si një CGU të veçantë. Vlera e shoqërisë respektive me 31 dhjetor 2018 u zbrit nga borxhi neto përkatës i shoqërisë për të përcaktuar vlerën e kapitalit të filialeve.

7. Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit

Shoqëriai ka dhënë huatë e mëposhtme filialeve të saj.

			31 dhjetor 2019				31 dhjetor 2018
Shumat në '000	**Shuma e huasë në monedhë origjinale (Euro)**	**Shuma e huasë në Lekë**	**Interesi i përllogaritur nëLekë**	**Totali në Lekë**	**Shuma e huasë nëLekë**	**Interesi i përllogaritur në Lekë**	**Totali nëLekë**
Lengarica & Energy Shpk	5,563	677,424	220,131	**897,555**	681,666	202,595	**884,261**
Mati Hydropower Shpk	5,677	691,349	121,774	**813,123**	694,546	102,449	**796,995**
Totali	**11,240**	**1,368,773**	**341,905**	**1,710,678**	**1,376,212**	**305,044**	**1,681,256**

Huatë dhënë Shoqërisë Lengarica & Energy Shpkjanë të varura nga pagesa e plotë e detyrimeve sipas Kontrates së Huamarrjes së Lengarica & Energy Shpk me Intesa SanPaolo Bank Albania sha. Norma e aplikuar e interesit gjatë 2019është 3% (2018: 3%).

Huatë dhënë Mati Hydropower janë të ripagueshme pas gjashtë muajve që nga momenti që hidrocentrali fillon prodhimin. Norma e aplikuar e interesit gjatë2019është 3% (2018: 3%).

8. Aktivet materiale

	Instalime dhe pajisje të tjera
Kosto	
Më 1 janar 2018	**494,956**
Shtesa	**-**
Më 31 dhjetor 2018	**494,956**
Shtesa	**-**
Më 31 dhjetor 2019	**494,956**
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2018	**(286,185)**
Shpenzime amortizimi	(52,192)
Më 31 dhjetor 2018	**(338,377)**
Shpenzime amortizimi	(39,144)
Më 31 dhjetor 2019	**(377,521)**
Vlera neto kontabël	
Më 1 janar 2018	208,771
Më 31 dhjetor 2018	**156,579**
Më 31 dhjetor 2019	**117,435**

9. Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera

	31 dhjetor 2019	**31 dhjetor 2018**
Llogari të pagueshme ndaj palëve të treta	4,335,499	4,526,622
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	330,971	177,725
Totali	**4,666,470**	**4,704,347**

Llogaritë e pagueshme konsistojnë kryesisht në shërbimet e konsulencave ligjore dhe konsulencave të tjera të papaguara në datën e raportimit.

10. Taksa dhe detyrime tatimore

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime për tatimin në burim	1,164,134	1,139,040
TVSH e pagueshme	202,264	201,804
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	14,508	13,392
Totali	**1,380,906**	**1,354,236**

11. Titujt e huamarrjes

	31 dhjetor 2019			31 dhjetor 2018		
Shumat në '000	**Shuma e huasë**	**Interesa të përllogaritur**	**Shuma totale**	**Shuma e huasë**	**Interesa të përllogaritur**	**Shuma totale**
enso hydro GmbH	599,142	43,339	**642,481**	604,792	21,545	**626,337**
Totali	**599,142**	**43,339**	**642,481**	**604,792**	**21,545**	**626,337**

Huatë përfshijnë huatë e marra nga enso hydro GmbH. Norma e interesit të aplikuar gjatë vitit 2019 është 3.75%. (2018: 3.75%).

12. Kapitali i paguar

Kapitali i paguari shoqërisë 2,612,737,000 Lekë (2018: 2,612,737,000 Lekë). Gjatë vitit 2019 nuk ka patur ndryshime në kapitalin e paguar.

	enso hydro GmbH % e pjesëmarrjes	IFC % e pjesëmarrjes	Vlera nominale Në Lekë
Në 31 Dhjetor2018	**2,090,189,600**	**522,547,400**	**2,612,737,000**
Në 31 Dhjetor2019	**2,090,189,600**	**522,547,400**	**2,612,737,000**
Në %	**80%**	**20%**	**100%**

13. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

	2019	2018
Të ardhura nga palë të treta	12,754,745	14,221,341
Totali	**12,754,745**	**14,221,341**

14. Shpenzime të personelit

	2019	2018
Pagat dhe shperblimet	69,888	64,512
Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	104,208	96,192
Totali	**174,096**	**160,704**

15. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

	2019	2018
Shërbime konsulence	8,802,393	18,625,489
Shërbime konsulence dhe shpenzime auditimi	1,101,207	1,591,192
Shpenzime përfaqësimi	184,394	177,980
Qiraja për zyrat	146,103	155,431
Kosto administrative	79,099	77,248
Tatime përveç tatimit mbi fitimin	63,000	63,000
Konsulencë ligjore	7,806	58,477
Të tjera	460,076	397,846
Totali	**10,844,078**	**21,146,663**

Audituesi ka ofruar vetem sherbimin e auditimit ligjor ne vleren 199,937 gjate vitit 2019.

Shërbimet e konsulencës kryesisht lidhen me shërbime konsulence manaxheriale dhe teknike nga Mati HydropowerShpknë masën 8,7milion Lekë (2018: 16 milion Lekë).

16. Të ardhura dhe shpenzime nga interesi

	2019	2018
Të ardhura nga interesi	40,939,179	43,879,063
Shpenzime interesi	(23,243,711)	(22,745,840)
Totali	**17,695,468**	**21,133,223**

17. Shpenzime të tjera financiare

	2019	2018
Fitime nga kursi i këmbimit	17,071,381	3,961,604
Humbje nga kursi i këmbimit	(31,525,994)	(95,685,940)
Totali	**(14,454,613)**	**(91,724,336)**

18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019është 15% (2018 :15%).Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por fitimet apo humbjet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	2019	2018
Fitimi / Humbja e vitit	4,938,281	(725,636,020)
Shpenzimet e pazbritshme	644,975	671,142,497
Fitimi/ (humbja) e tatueshme për vitin	***5,583,256***	***(54,493,523)***
Perdorimi i humbjeve tatimore te mbartura	**(54,493,523)**	
Diferenca	**(48,910,267)**	

Nuk është njohur një aktiv tatimor i shtyrë ne lidhje me humbjet tatimore të mbartura sepse menaxhimi beson se nuk është e mundshme që në të ardhmen do të ketë fitim të tatueshëm, kundrejt të cilit shoqëria mund të kompensojë humbjet e saj. Aktivtatimor i shtyrë nuk është njohur edhe për sa i përket zhvlerësimit të titujve të pronësisë në njësitë brenda grupit, sepse zhvlerësimi është i pazbritshëm për qëllime tatimore dhe është e pasigurt që në të ardhmen do të lindin përfitime tatimore nga zhvlerësimi i aktiveve financiare perkatëse.

19. Palët e lidhura

Gjatë kryerjes së veprimtarisë normale të biznesit, shoqëria kryen transaksione me palet e lidhura. Shoqëria kryen transaksione me shoqërinë mëmëtësaj dhe me filialet e saj. Balancat dhe transaksonet e shoqërisëme palët e lidhura në datën e bilancit janë si më poshtë:

	Marrëdhënia	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktive			
Huadhënie			
Lengarica & Energy Shpk	Filial	897,554,290	884,260,919
Mati Hydropower Shpk	Filial	813,123,407	796,994,983
Të arkëtueshme të tjera			
Lengarica & Energy Shpk	Filial	-	5,299,694
Detyrime			
Detyrime te tjera			
Mati Hydropower Shpk	Filial	330,971	177,725
Huamarrje			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	642,480,850	626,337,420
Pasqyra e performances			
Shpenzime ushtrimore			
Mati Hydropower Shpk	Filial	8,694,936	16,599,527
Të ardhura nga interesi			
Lengarica & Energy Shpk	Filial	20,244,242	23,042,682
Mati Hydropower Shpk	Filial	20,694,937	20,836,381
Shpenzime interesi			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	23,243,711	22,745,840

Kompesimi i personelit drejtues të shoqërisë gjatë 2019 është 174,096 Lekë (2018: 160,704 Lekë).

20. Ngjarje pas periudhës së raportimit

Që nga 31 dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka ndikuar rëndë në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset po detyrohen të ndërpresin ose kufizojnë operacionet për periudha të gjata ose të pacaktuar kohore. Masat e marra për të ngadalësuar përhapjen e virusit kanë shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në një ngadalësim ekonomik. Tregjet globale të aksioneve kanë provuar gjithashtu një paqëndrueshmëri të madhe dhe një dobësim të ndjeshëm. Qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjigjur me ndërhyrje monetare dhe fiskale për të stabilizuar kushtet ekonomike.

Ndërsa Shoqëria po operon në biznesin e gjenerimit të energjisë elektrike, operacionet e saj nuk janë ndërprerë nga situata. Në datën e hartimit të këtyre pasqyrave financiare drejtimi nuk pret ndonjë ndikim financiar të rëndësishëm negativ pas shpërthimit të Koronavirusit për vitin aktual. Shoqëria ka përcaktuar që këto ngjarje janë ngjarje pas datës së raportimit të cilat nuk kërkojnë korrigjime. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e operacioneve më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 nuk janë rregulluar. Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjeve të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime apo shënime të tjera shpjeguese në këto pasqyra financiare individuale.